



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 korrik 2016
Nr. ref.:RK961/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI153/15

Parashtrues

Bekë Sh. Lajçi

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 219/15, të 1 shtatorit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bekë Sh. Lajçi, avokat nga Peja.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 219/2015, i 1 shtatorit 2015, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 12 tetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, për të cilin parashtruesi pretendon se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] nenit 24 [Barazia para Ligjit], dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe, po ashtu nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
4. Parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) aplikimin e masës së përkohshme.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 19 dhjetor 2015, nëpërmjet postës, parashtruesi e dërgoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës me vendim caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan, Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 19 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe një kopje të kërkesës i dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 17 maj 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 9 tetor 2012, Gjykata Themelore në Pejë, nxori Aktgjykimin, C. nr. 1045/2005, me të cilin e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e palës paditëse A. D., ashtu që të paditurin (në këtë rast parashtruesin), e detyroi që paditëses t'i kompensojë shumën e caktuar të parave si në vendim në emër të kompensimit të dëmit të fituar, si pasojë e pasurimit të pabazë, për shkak se ai në cilësinë e avokatit i kishte marrë asaj më shumë para për përfaqësime në gjykatat e rregullta se sa që atij i takonin sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

11. Aktgjykimin e vet Gjykata Themelore e kishte bazuar në provat e paraqitura nga paditësja, deklaratat e të paditurit si dhe ekspertizën e ekspertit gjyqësor, avokatit T. B. Gjykata Themelore, ndër të tjera, në aktgjykim kishte theksuar:

“Nga provat e nxjerra rezulton se i padituri të paditurën e ka përfaqësuar në 5 lëndë para Gjykatës Komunale në Pejë, dhe se për këto shërbime të njëjtit sipas tarifës së Odës së avokatëve të Kosovës i ka takuar shuma prej 3675,40 euro, kështu që i njëjti është i obliguar që paditëses t’ia kthejë shumën prej 7124,60 euro, si fitim i pabazë, për shkak se nuk është në pajtim me tarifën e Odës së avokatëve të Kosovës”.
12. Më 20 prill 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin Ac. nr. 4953/2012, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
13. Në arsyetimin e Aktgjykimit të vet Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka theksuar: *“Kjo gjykatë duke e vlerësuar përfundimin dhe mendimin e gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është i drejtë, i bazuar se ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe në dispozitat ligjore, ndërkohë që janë dhënë arsyet e justifikueshme, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë”.* Gjykata e Apelit, më tej, ka shtuar se: *“Pretendimet ankimore të paditurit, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare”.*
14. Më 19 mars 2015, parashtruesi ka paraqitur kërkesë për Revizion në Gjykatën Supreme për shkak të: 1. Shkeljes së standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut për një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, për shenjën e drejtësisë së kërkuar (nr. 6, i KEDNJ-së), 2. Shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale nga neni 118, par. 1 dhe 2 etj. lidhur me nenin 208 të LPK-së, dhe 3. Aplikimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale (n. 395 të LPK-së) etj. Në Gjykatën Supreme parashtruesi kishte kërkuar edhe aplikimin e masës së përkohshme, ndalimi i zbatimit të përmbarimit të dhunshëm të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Pejë, P. nr. 1045/2005.
15. Më 1 shtator 2015, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 219/2015 refuzoi, si të pabazuar kërkesën për revizionin e parashtruesit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 4953/2012, të 20 prillit 2015.
16. Lidhur me pretendimet e parashtruesit, e sidomos mbi ato për shkeljen e të drejtave të njeriut, Gjykata Supreme kishte arsyetuar: *“Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi pretendimet e revizionit për shkelje të standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, për një proces gjyqësor, të drejtë dhe të paanshëm për dhënie të drejtësisë së kërkuar, të parapara me nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, dhe të njëjtat i vlerësoi si të pabazuara, nga se në revizion vetëm në mënyrë të përgjithshme thuhet se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë shkelje të tilla të kësaj konvente, pa u sqaruar më konkretisht se cilat janë ato, dhe ku qëndrojnë, andaj kjo gjykatë konstaton se janë të pabazuara thëniet në*

revizion përkitazi me shkeljet e tilla të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut”.

17. Gjykata Supreme, gjithashtu, iu kishte referuar një nga një të gjitha pretendimeve të parashtruesit, lidhur me shkeljet procedurale dhe aplikimit të gabuar të ligjit dhe të gjithave u kishte dhënë arsyetim adekuat dhe të gjerë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me vendimet e kontestuara i janë shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së), sepse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk është i arsyetuar, ndërsa sipas tij, neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së kanë kërkesë imperative arsyetimin e vendimeve të nxjerra nga gjykatat, dhe se gjithashtu gjatë procesit gjyqësor nuk është respektuar parimi i barazisë së armëve në procedurë.
19. Parashtruesi i kërkesës, më tej, kishte theksuar se provat e paraqitura nga ana e tij në gjykatë nuk ishin trajtuar njësoj sikur ato të paraqitura nga paditësja si dhe ka potencuar faktin që gjykata nuk mori parasysh faktin se ai me klientin e tij kishte marrëveshje gojore e cila korrespondon me nenin 4.2 të tarifës së Odës së Avokatëve *“që do të thotë tarifa e dyfishuar”*.
20. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, thekson se ai dhe kolegu i tij, avokati F. GJ., kanë ndërmarrë veprime juridike në llogari të fëmijëve të parashtruesit: A. D., E. D. dhe L. D., si dhe kanë ndërmarrë edhe shumë veprime të tjera juridiko-administrative, si: fotokopjime, fotografime të vendosjes së pronave, nxjerrje të dokumentacionit pronësor etj. në llogari të parashtrueses dhe të pasardhësve të saj, e që gjykatat e rregullta nuk i kanë marrë parasysh si prova, që sipas parashtruesit rezultoi me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës [Barazia para Ligjit].
21. Shkelja e nenit 46 të Kushtetutës, lidhur me nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së [Mbrojtja e Pronës], ka ndodhur, sipas parashtruesit, sepse ai me vendime gjyqësore në mënyrë arbitrare është privuar nga e drejta e pronës mbi shumën e parave të cilën, sipas tij, e kishte fituar në mënyrë të ligjshme, duke ia mohuar edhe pritjen legjitime mbi atë “pronë” të cilën gjithsesi që e gëzonte mbi bazën e punës së kryer.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Më tej, Gjykata, merr në konsideratë nenin 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

25. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

dhe

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

26. Në vlerësimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi, Gjykata vëren që kontestohet Aktgjykimi Rev. nr. 219/2015, 1 shtatorit 2015.

Dispozitat relevante kushtetuese lidhur me rastin

Neni 31 [E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose

përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.

[...]

Neni 6 i KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt]

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e Gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

[...]

27. Duke vlerësuar kushtetutshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në relacion me pretendimet për shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së dhe fakteve të prezantuara nga parashtruesi, duke i krahasuar këto fakte me përmbajtjen e dispozitave si më lart, Gjykata konstaton se këto pretendime janë mbështetur në “konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vlerësimin e gabuar dhe jo të barabartë të provave të prezantuara nga palët në proces nga ana e gjykatave të rregullta, mungesën e arsyetimit të mirëfilltë në vendimet gjyqësore. Në këtë drejtim gjykata do të shqyrtojë veç secilin prej pretendimeve të ngritura nga ana e parashtruesit”.

Shkelja e pretenduar e nenit 31 të Kushtetutës – nenit 6 të KEDNJ

28. Gjykata thekson se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm [Neni 31 i Kushtetutës] është një nga të drejtat më qenësore të parapara me kapitullin II të Kushtetutës, dhe është parakusht për jetësimin e parimit të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike.
29. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar, se sipas rregullave të përgjithshme është kompetencë lëndore dhe detyrë e gjykatave të rregullta të vlerësojnë faktet të cilat gjenden para tyre (Shih rastin KI47-48/15, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-14-0057, të 12 marsit 2015, parashtrues *Beqir Kosokoviku e Mustafë Lutolli*), gjithashtu, nuk është detyrë e Gjykatës, të konstatojë nëse dëshmitarë të caktuar janë thirrur për të dëshmuar apo dëshmi të caktuara janë zgjedhur për t'u trajtuar para gjykatave të rregullta, sikur ka potencuar parashtruesi apo

nëse deklaratat e dëshmitarëve në mënyrë korrekte janë prezantuar si prova të rastit (Shih, *Kostovski vs. Nederland*, pika 39.1989).

30. Nuk është kompetencë e Gjykatës që me vlerësimin vetjak të fakteve të zëvendësojë vlerësimin e bërë nga ana e gjykatave të rregullta, sepse detyrë e kësaj gjykate është të vlerësojë nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 6 të KEDNJ-së, respektivisht me nenin 31 të Kushtetutës (Shih, ndër të tjera, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A, nr. 247 dhe B . *Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992, f. 33, Seria A, nr. 235)
31. Për Gjykatën, në parim, janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave kushtetuese dhe jo çështjet qartazi ligjore, që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi. (Shih, *mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
32. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund të marrë rolin e gjykatës së shkallës së katërt dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore (Shih rastin *Fc Metrebi vs. Georgia*, par. 31, aktgjykim i GJENDJ-së, i 31 korrikut 2007), e që gjykuar sipas rrethanave të rastit qëllimi primar i parashtruesve duket të ketë qenë pikërisht kontestimi i rezultatit të procesit gjyqësor.
33. Në relacion me pretendimet e parashtruesit, Gjykata thekson se e drejta në vendim të arsyetuar gjyqësor është një nga elementet qenësore të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ-në, dhe dështimi i gjykatave apo i autoriteteve të tjera publike për të arsyetuar vendimet e tyre në masën e kërkuar me garancitë procedurale dhe përmbajtjesore të nenit 6 të KEDNJ-së, gjithsesi që rezulton me cenimin e kësaj të drejte.
34. Mirëpo, Gjykata konstaton se asgjë në rastin e prezantuar nga parashtruesi nuk provon që gjykatat e rregullta kanë dështuar të arsyetojnë vendimet e tyre dhe se procesi gjyqësor në rastin konkret, si tërësi, ka qenë i padrejtë apo arbitrar, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të gjejë se është cenuar vetë esenca e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
35. Bazuar në atë që u tha më lart, i ka takuar gjykatave të rregullta të vlerësojnë gjendjen faktike dhe për më tepër atë gjendje të konstatuar e kanë mbështetur edhe në raportet e ekspertëve të lëmit përkatës. Gjithashtu, Gjykatës, nuk iu ofrua asnjë provë për trajtimin e pabarabartë të palëve në procedurë që do të ishte tregues i faktit se parashtruesin e kishte vënë në një situatë të pafavorshme në raport me palën oponente, për aq sa ta degradojë thelbësisht procesin gjyqësor në tërësinë e tij (Shih *Dombo Beheer kundër Holandës* aktgjykim i 27 tetorit 1993, Serie A, nr. 274), andaj, në këto rrethana, Gjykata nuk gjen se me vendimet e kontestuarra ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.
36. Gjykata, për më tepër, konstaton se Gjykata Supreme si dhe gjykatat e instancës më të ulët (Shih paragrafët 10.11.15 të aktvendimit), i kishin

arsyetuar plotësisht vendimet gjyqësore dhe lidhur me pretendimet e parashtruesit dhe veçanërisht ato që lidhen me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe duke sqaruar në mënyrë të duhur se, pse ato nuk ishin shkelur e gjithashtu ishin arsyetuar edhe pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore të ngritura nga parashtruesi.

Shkelja e pretenduar e nenit 46 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së

37. Sa i përket pretendimit të parashtruesit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës [Mbrotjtja e Pronës], lidhur me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në mënyrë të gabuar i ishte qasur konceptit të “pronës” dhe konceptit të “pritjes legjitime” në raport me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe me praktikën ekzistuese të Gjykatës Kushtetuese, kur ka përmendur raste nga praktika gjyqësore e këtyre institucioneve, e që nuk janë të aplikueshme në rastin e parashtruesit.
38. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së nuk ekziston një “pritje legjitime” në rastet kur ekziston kontest në interpretimin dhe aplikimin e ligjit në fuqi, e gjykatat e rregullta të sistemit vendor i hedhin poshtë apo i refuzojnë parashtruesit sikur ka ndodhur në rastin konkret (Shih rastin *Jantner vs. Slovakia*, aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 4 marsit 2003).
39. Në rrethanat e këtij rasti, nuk ka vend krahasimi me rastet e bashkuara KI58/09, 59/09.....13/10 (Shih Aktgjykimin e Gjykatës, parashtrues *Gani Prokshi e 15 ish-punëtorë të tjerë të KEK-un*), sepse në atë rast Gjykata, duke iu referuar të drejtës së pronës, pritjes legjitime lidhur me pronën, ndër të tjera, në par. 58, kishte konstatuar: “Gjykata Kushtetuese konsideron që parashtruesit, me nënshkrimin e marrëveshjeve me KEK-un, kanë pasur pritje legjitime që do të gëzojnë dëmshpërblim mujor në shumën prej 105 eurosh, deri në themelimin e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor”.
40. Gjykata, më tej, në arsyetimin e atij aktgjykimi kishte theksuar: “Një pritje e tillë legjitime garantohej me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, natyra e saj është konkrete, dhe jo vetëm një shpresë e thjeshtë, dhe bazohet në një, dispozitë ligjore apo akt ligjor, d.m.th. Marrëveshjen me KEK-un” (Shih *Ibrahimi dhe të tjerët* dhe shih po ashtu, *mutatis mutandis*, *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (dec.), nr. 39794/98, paragrafi 73, ECHR 2002-VII).
41. Gjykata, pra, në rastin e lartpërmendur kishte konstatuar pa asnjë dyshim se ndërmjet palëve ekzistonte një marrëveshje me shkrim detyruese për palët, e shuma të përcaktuara monetare që duhet të paguheshin në shuma mujore, ndërsa, në rastin e parashtruesit nuk kemi një marrëveshje të tillë, dhe aq më tepër kur kompensimi monetar për shërbimet e ofruara nuk bazohet në një akt juridik të formalizuar por sipas parashtruesit në një marrëveshje gojore saktësinë e të cilës e vlerësuan gjykatat e rregullta me vendimet gjyqësore që rezultuan të jenë në jo përputhshmëri me pretendimet e parashtruesit.

42. Në këto rrethana, Gjykata nuk gjen se ka elemente të një pritshmërie legjitime për pronë dhe rrjedhimisht, as shkelje të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

43. Rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, përcakton që *“në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme”*.

44. Gjykata, më tej, i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, që parasheh:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës; (b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe (c) Masa e përkohshme është me interes publik.

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

45. Megjithatë, pasi që kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar dhe si e tillë, e papranueshme, Gjykata konkludon se kërkesa për masë të përkohshme nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit dhe, rrjedhimisht, duhet të refuzohet.
46. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese apo të drejte të garantuar me KEDNJ, andaj, nuk mund të konstatohet se ka cenim të të drejtave të njeriut me vendimin e kontestuar dhe në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika b) dhe d), gjen se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 17 maj 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi